



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Shpallje për lëvizje paralele
Ngritje në detyrë
Në kategorinë e ulët drejtuese

Përgjegjës Sektori për Projektet e Zhvillimit

Në zbatim të Kreut V të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Korçë shpall procedurat e lëvizjes paralele, dhe ngritjes në detyrë për pozicionin:

1 (një) Përgjegjës i Sektorit për Projektet e Zhvillimit - kategoria: III-2

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për dy procedurat; lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Lëvizje paralele

18.01.2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Ngritje në detyrë

23.01.2026

Përshkrimi i punës për pozicionin

Organizon, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e strukturës përkatëse dhe të specialistëve në varësi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, vendimet e Këshillit të Qarkut dhe urdhrat e Titullarit të Institucionit. Në këtë kuadër, përgjegjësitë kryesore përfshijnë:

- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe strategjive për zhvillimin ekonomik rajonal, si dhe hartimin dhe monitorimin e projekteve të investimeve publike, përfshirë përgatitjen e dokumentacionit, realizimin brenda afateve dhe hartimin e raporteve teknike e financiare për zbatimin e kontratave.
- Hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe strategjive në fushat e arsimit, kulturës, shëndetësisë dhe çështjeve sociale, në përputhje me strategjinë e zhvillimit rajonal, si dhe koordinimin e procesit të grumbullimit, sistemimit dhe përditësimit të të dhënave në këto fusha.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të planit vjetor të projekteve zhvillimore në fushat e arsimit dhe kulturës, si dhe përgatitjen e hartës së shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në nivel rajonal.
- Bashkëpunimin institucional me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimin Social Shtetëror, si dhe monitorimin e realizimit të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian të zbatuara nga Këshilli i Qarkut Korçë.
- Mbikëqyrjen e menaxhimit të dosjeve të urbanistikës dhe të vlerësimit të dëmeve në rast emergjencash civile,
- Përgatitjen e raporteve për Këshillin e Qarkut Korçë mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve në territorin

e qarkut.

- Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë, apo të kërkuar nga Titullari i Institucionit, në përputhje me ligjin.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë III;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Shoqërore/ Sociale/ Inxhinieri Ndërtimi/ Ekonomike/ Juridike edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë bashkë me kërkesën ku specifikohet pozicioni që dëshironi të konkuroni duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
(*Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës*)
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID) të rregullt;
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (Vërtetim i aftë për punë);
- f- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt (Formulari i vlerësimit në punë);
- h- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;

*Dokumentet duhet të dërgohen me postë ose të dorëzohen në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, në adresë: Lagjia 7, Rruga “28 Nëntori”, Korçë 7001, Shqipëri, brenda datës: **18.01.2026***

1.3

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **19.01.2026**, Këshilli i Qarkut Korçë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Këshilli i Qarkut Korçë për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Njohuritë mbi ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”
- Njohuritë mbi ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit”
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”
- Njohuritë mbi ligjin nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Njohuritë mbi VKM nr. 563 datë 12.08.2005, “Për përcaktimin e përgjegjësisë të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror”,
- Njohuritë mbi Udhëzim nr. 1, datë 02.02.2007 Mbi zbatimin e VKM 563 “Për përcaktimin e përgjegjësisë të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror”
- Njohuritë mbi VKM nr. 111 datë 23.02.2018 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Fondit Social”
- Njohuritë mbi VKM nr. 152, datë 13.3.2024 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”.
- Njohuritë mbi VKM nr. 150, datë 20.3.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Korçë, do të shpallë fituesin në faqen zyrtare (<https://qarkukorce.gov.al/>) dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli i Qarkut Korçë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2

NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Qarkut Korçë, duke filluar nga data 19.01.2026

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IV;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Shoqërore/ Sociale/ Inxhinieri Ndërtimi/ Ekonomike/ Juridike edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion;

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë bashkë me kërkesën ku specifikohet pozicioni që dëshironi të konkuroni duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
(Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës)
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID) të rregullt;
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (Vërtetim i aftë për punë);
- f- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt (Formulari i vlerësimit në punë);
- h- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;

Dokumentat për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të dërgohen me postë ose të dorëzohen në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, në adresë: Lagjia 7, Rruga “28 Nëntori”, Korçë 7001, Shqipëri, brenda datës: 23.01.2026

2.3

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data **26.01.2026**, Këshilli i Qarkut Korçë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit "https://qarkukorce.gov.al/" dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli i Qarkut Korçë, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore"
- Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015, "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"
- Njohuritë mbi ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"
- Njohuritë mbi ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit"
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike"
- Njohuritë mbi ligjin nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Njohuritë mbi VKM nr. 563 datë 12.08.2005, "Për përcaktimin e përgjegjësive të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror",
- Njohuritë mbi Udhëzim nr. 1, datë 02.02.2007, mbi zbatimin e VKM nr. 563 "Për përcaktimin e përgjegjësive të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror"
- Njohuritë mbi VKM nr. 111 datë 23.02.2018 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Fondit Social"
- Njohuritë mbi VKM nr. 152, datë 13.3.2024 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj".
- Njohuritë mbi VKM nr. 150, datë 20.3.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror"

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

KQK Shpallje për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Korçë do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*). Këshilli i Qarkut Korçë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare “<https://qarkukorce.gov.al>” dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.